

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE, gjyqtari Nazim Villaço me sekretaren juridik Shykran Celina, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit, Fariz Mazrek pronari i subjektit ekonomik “ PO Petrol Fariz biznes individual “ me seli në Mamushë, për shkak të kundërvajtjes nga neni 4 të Ligjit për Tregtinë me Naftë dhe Derivatet e Naftës në Kosovë nr. 2004/5 e sanksionuar si pas nenit 14 pika 1 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Tregtinë me Naftë dhe Derivateve të Naftës në Kosovë nr. 03/L-138, e në bazë të nenit 31, 35, 55, 77, 86, 124 dhe 129 të Ligjit për Kundërvajtjet nr.05/L-087, duke vendosur sipas rekomandimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës me aktvendim të kësaj gjykate Ka.nr.410/2022 të dt. 02.11.2022 më dt. 16.03.2023 merr këtë:

Nr./Br./No 2849/19 Nr./faq./Br./No.pg 1 **A K T G J Y K I M**

Data/Datum/Date 18.05.23

I Pandehuri: Fariz Mazrek pronari i subjektit ekonomik “ PO Petrol Fariz biznes individual “ me seli në Mamushë

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S

Sepse me date 24.03.2021, gjate inspektimit të kryer nga ana e Inspektoratit të Tregut të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në Prishtinë se subjekti ekonomik “ Po Petrol Fariz “ me seli në Mamushë, është konstatuar se veprimtarinë e shitjes të NDN e ushtron pa licencë të veçantë për NDN.

Me te cilin veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 6 të Ligjit nr.08/L-18 për tregtinë me produktet e naftës dhe karburanteve të ripërtërishme të ndëshuar si pas nenit 19 par. 2 të po të njejtit ligj.

Andaj, në bazë të dispozitës ligjore të lartshënuar .

D E N O H E T

Me dënim me gjobe prej 1.000 euro / njëmijë euro /.

I pandehuri obligohet që gjobën e shqiptuar dhe shumën prej 5 Euro, në emër të shpenzimeve të procedurës të paguaj në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e Aktgjykimit, a po varësisht nga gjendja ekonomike, mund të e paguan edhe me 2 këste duke u bazuar në nenin 30 par.1 të Ligjit për kundërvajtje, Nr.05/L-087, në të kundërtën gjoba e shqiptuar dhe shpenzimet e cekura më lartë, do të arkëtohen me dhunë në bazë të dispozitave mbi arkëtimin me dhunë të tatimit, në vështirimin të nenit 163 par. 4 të ligjit për Kundërvajtje. I pandehuri poashtu, obligohet që pas kryerje së pagesës ta njoftoj këtë gjykatë.

Shpenzimet e procedurës së kundërvajtjes janë shqiptuar në përputhje me nenin 59 të Ligjit për Kundërvajtje.

A r s y e t i m i

Sipas kërkesës së Inspektoratit të Tregut të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe në Prishtinë me nr. 19/21 të dt. 13.04.2021, është ngritur procedura kundërvajtës kundër të pandehurit Fariz Mazrek pronari i subjektit ekonomik “ PO Petrol Fariz “ biznes individual “ me seli në Mamushë, për shkak të kundërvajtjes nga neni 4 të Ligjit për Tregtinë me Naftë dhe Derivatet e Naftës në Kosovë nr. 2004/5 e sanksionuar si pas nenit 14 pika 1 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Tregtinë me Naftë dhe Derivateve të Naftës në Kosovë nr. 03/L-138.

Me aktvendimin e e Gjykatës Themelore në Prizren - Divizioni për Kundërvajtje, Ka. nr.48-04/2021 të dt. 11.08.2022, ndaj të pandehurit Fariz Mazrek nga Mamusha është pezulluar procedura kundërvajtëse, për shkak të kundërvajtjes së njëjtë për të cilën është dënuar me aktvendimin e inspektoratit të tregut me nr. 19/21 të dt. 13.04.2021.

Kundër këtij aktvendimi me dt. 06.09.2022, Inspektorati I Tregut të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë ka ushtruar ankesë, Gjykatës së Apelit të Kosovës, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të drejtës materiale dhe aplikimit të gabuar të procedurës kundërvajtëse.

Gjykata e Apelit të Kosovës me aktvendimin Ka.nr. 410/2021 të dt. 02.11.2022, e ka apovuar ankesën e Inspektorit të Tregut, dhe lëndën ka kthyer Gjykatës së shkallës së pare në rivendosje, duke rekomanduar që përsëri të ftohet ushtruesi I kërkesës inspektori I tregut.

Gjykata e shkallës së pare me dt.16.03.2023, ka marrë deklaratën e inspektorit të tregut Eljesa Beqiri, I cili në deklaratën e vet ka theksuar se Fariz Mazrek subjekti I biznesit individual “ PO Petrol Fariz “ me seli në Mamushë e ushtron veprimtarin për tregti të naftës dhe derivative të naftës pa licencë, gjë që ishte konstatuar, në procesverbalin nr. 0124 të dt. 24.03.2021.

Në përputhje me nenin 31 dhe 35 të Ligjit mbi Kundërvajtje, me rastin e caktimit të sanksionit kundërvajtës ndaj të pandehurit më tepër janë parur parasyshtë rrethanat lehtësuese ngase më pare nuk ka qenë I dënuar për kundërvajtje të kësaj natyre që vejnë në dukje se edhe me një sanksion kundërvajtës më të butë mund të arrihet qëllimi i sanksionit kundërvajtës, dhe për këtë është shqiptuar dënimi nën masën minimale të paraparë për këtë kundërvajtje në përputhje me nenin 35 të Ligjit për kundërvajtje.

Ndaj të pandehurit Fariz Mazrek pronari i subjektit ekonomik “ PO Petrol Fariz” biznes individual “, në rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit është zbatuar neni 5 par. 2 të Ligjit për Kundërvajtje - **Parimi I zbatimit të legjislacionit më të favorshëm**, ku në paragrafin 2 ceket “ nëse legjislacioni në fuqi ndryshon pas kryerjes së kundërvajtjes, ndërsa para nxerjes së vendimit të formës të prerë për kundërvajtje, do të zbatohet legjislacioni i cili është më i favorshëm për kryersin “.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi,

Nga një ekzemplarë të këtij aktgjykimi do t'i dërgohet të pandehurit dhe parashtruesit të kërkesës.

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE
K-48-04/2021

Sekretarja juridike
Shykran Celina

dt.16.03.2023

Gjyqtari
Nazim Vllaço

UDHËZIMI JURIDIK : Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur, mund të ushtrojë ankesë, në afat prej 8 ditëve, nga dita e pranimit të njëjtës, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Divizioni për Kundërvajtje, përmes kësaj gjykate.

